



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PERMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Nr.449/Prot.

Tiranë, me dt.27/02/2020

U R D H Ë R

*"Heqjen e Masës së Sekuestros"*

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit

T I R A N Ë

**Për dijëni: Debitori, Shoqëria "M.T.C ENERGY" sh.p.k, përf. Leonidas Manaitakis**

**Adresa:** Rruga "Hajdar Hidi", Ndërtesa 2, Hyrja 4, Ap.2

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. çertifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.414/Regj, bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.1047-(703), datë; 13.06.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë,

**KONSTATOVA:**

Se me datë; 18.11.2019 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Korçë, së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Vendim administrativ nr. ISHPSHSH-0004258, datë 18.02.2015, me palë dhe objekt:

**Kreditor : Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Korçë**

**Debitor : Shoqëria "M.T.C ENERGY" sh.p.k, përf. Leonidas Manaitakis**

**Objekti: Pagim gjobe**

Ekzekutimi i titullit ekzekutiv, në mbështetje të nenit 519 të K. Pr. Civile, ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për rrjedhojë, bazuar në nenin 527, 529 e në vijim të K. Pr. Civile, është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros mbi kuotat/kapitalet e palës debitore.

Në vijim të procedurave jemi kontaktuar nga pala debitore i cili pasi është njohur me veprimet përmbarimore deklaroi se kërkon të bëjë shlyerje pjesore të detyrimit, me qëllim heqjen e masës së sekuestros nga ana e Zyrës Përmbarimore. Për këtë fakt, është mbajtur dhe proces- verbal me palën debitore.

Sa sipër, bazuar në marrëveshjen e arritur ndërmjet palës debitore dhe zyrës përmbarimore për shlyerje të detyrimit me këste, duhet të hiqet masa e sekuestros mbi kuotat apo kapitalet e shoqërisë debitore.

**U R D H Ë R O J:**

Heqjen e masës së sekuestros mbi aktivet e palës debitore **Shoqëria "M.T.C ENERGY" sh.p.k, përf. Leonidas Manaitakis, me NIPT K91524003T.**

***Në rast se mbi aktivet e shoqërisë palë debitore ka sekuestro nga institucione të tjera apo zyra përmbarimore, ato nuk hiqen mbeten në fuqi.***

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda 3 ditëve nga marrja dijëni.

Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile  
Ky urdhër ju komunikohet palëve në proces ekzekutimi të cilët kanë të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 5 ditëve nga marrja dijani.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

